



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .01.2022

MBLEDHJA Nr. 04,
datë 26.01.2022, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 26.01.2022, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 04 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Çështje të tjera
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ERE, për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror
3. Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar, dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar
4. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s, nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror”, Albgaz sh.a.”, i ndryshuar
5. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Dhjetor 2021
6. Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a. për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr.104, datë 23.06.2016, të bordit të ERE, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrishme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE nr.49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013”

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i

shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI